



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 452, datë 31.07.2024

PËR

EMËRIMIN GJYQTAR TË Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 136/a dhe 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 35 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 2, shkronja “a”, nenin 86, shkronja “a” dhe nenin 97, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bazuar në vendimin nr. 383 datë 29.07.2024, “Për kualifikimin për emërim të kandidatit të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, z. {...}”, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

V E N D O S I :

1. Të emërojë gjyqtar z. {...}.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kandidatit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR